

MASTERI PROFESIONAL INFERMIERI FAMILJEJE

Programi i Masterit Profesional në “Infermieri Familjeje” synon të përgatisë staf infermior të kualifikuar për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve dhe rehabilitimin e pacientëve, si në qendrat e Kujdesit Shëndetësor Parësor, ashtu edhe në banesë. Programi i përgjigjet kërkesave në rritje për kujdes të specializuar në banesë, si pasojë e plakjes së popullsisë dhe rritjes së prevalencës së sëmundjeve kronike.



Të dhëna bazë:

Viti i hapjes: 2021

Kohëzgjatja: 1 vit akademik

Forma e studimit: Me kohë të plotë

Kredite: 60 ECTS

Programi: 8 lëndë, praktikë profesionale, temë diplome.

Pjesëmarrja ndër vite

Studentë	Të regjistruar	Të diplomuar
2021	14	14
2022	18	18
2023	—	—
2024	—	—
2025	16	...

SEMESTRI I

- Infermieri Familjeje (koncept&teori)
- Menaxhimi infermior i sëmundjeve kronike
- Infermieri e bazuar në evidencë
- Promovimi i shëndetit
- Praktikë profesionale në QSH

SEMESTRI II

- Infermieri Familjeje (geriatri&psikiatri)
- Menaxhimi infermior i sëmundjeve kronike
- Vlerësimi klinik
- Lëndë me zgjedhje në logoterapi
- Praktikë profesionale në QSH

Kontributi i HAP

- Ofroi ekspertizë teknike për grupin multidisiplinar të punës të përbërë nga specialistë të Universitetit të Mjekësisë, FSHTM-së, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Urdhrit të Mjekut, Urdhrit të Infermierit dhe ofruesve të kujdesit shëndetësor parësor - me qëllim hartimin e një kurrkule bashkëkohore.
- Zhvilloi kapacitetet e stafit akademik, duke mbështetur pedagogët me literaturë referencë, trajnime nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, si dhe vizita studimore në institucione arsimore ndërkombëtare.
- Forcoi infrastrukturën e mësimdhënies përmes ngritjes së një Laboratori Simulimi për Praktikën Klinike në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT), duke mbështetur zhvillimin e aftësive praktike klinike të studentëve.
- Kontribuoi në procesin e të nxënimit të studentëve duke mbështetur hartimin e teksteve mësimore dhe shpërndarjen e tyre pa pagesë për çdo vit akademik.
- Përgatiti mentorë klinikë duke trajnuar mbikëqyrësit e praktikave dhe ekipet infermiore në qendrat shëndetësore për të udhëhequr studentët në zhvillimin e kompetencave praktike.
- Përmirësoi mjediset e praktikës profesionale duke përmirësuar infrastrukturën e disa qendrave të kujdesit shëndetësor parësor ku zhvillohet praktika.